

VENDIM
Nr. 758, datë 12.11.2014

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, PA SHPËRBLIM, NGA MINISTRIA E MBROJTJES
TE MISIONI I BAMIRËSISË “MOTRAT E NËNË TEREZËS”, TË PRONËS NR.
1218, ME EMËRTIM “SPITALI DHE SHLU”, ME VENDNDODHJE NË PUKË, SI
DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 4, e 4, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të nenit 761 e neneve në vijim, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes te misioni i bamirësisë “Motrat e Nënë Terezës”, të pronës së paluajtshme shtetërore nr. 1218, me emërtim “Spitali dhe SHLU”, me vendndodhje në Pukë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas formularit standard të inventarizimit, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, për t’u përdorur nga misioni i bamirësisë “Motrat e Nënë Terezës”, për banim dhe zhvillim të veprimtarisë së tyre në qytetin e Pukës.

2. Prona nr. 1218, me emërtim “Spitali dhe SHLU”, me vendndodhje në Pukë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Misionit të bamirësisë “Motrat e Nënë Terezës”, i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës nr. 1218, me emërtim “Spitali dhe SHLU”, me vendndodhje në Pukë, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe misioni i bamirësisë “Motrat e Nënë Terezës”, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave si klasa të veçanta)

MINISTRIA E MBROJTJES Bashkia Pukë Fusha e përdorimit të pronës Për Mbrojtjen Kombëtare										
	A		B				C			
Nr.	Zona kadastrale, indeksi i hartës	Numri i pasurisë	Emërtesa e pronës vendndodhja/shtrirja gjeografike	Komponentët përbërës të pronës	Adresa/vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m ² ose MI	Funksioni për të cilin përdoren pronat	Enti me përgjegjësi administrative	Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera, shënime të veçanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1218			Spitali dhe SHLU		PUKË	4301m ²	Për mbrojtjen	Ministria e Mbrojtjes Re. Ush. Nr. 7001 (BMR)	Reparti ushtarak Nr. 7010	-Identifikuar me të dhënat e formularit standard dhe të planvendosjes dërguar me shkresën e BMR .nr. 3566, datë 23.10.2012
			Objekti nr. 4 2 kate			307.05				
			TRUALL			3993.95				